



Ministero dell'Istruzione, dell'Università e della Ricerca
Ufficio Scolastico Regionale per la Toscana
Ufficio Scolastico Provinciale di Livorno



Repubblica di Albania
Republika e Shqipërisë

KUSHTETUTA E REPUBLIKES ITALIANE

Parime Themelore

Neni 1 - Italia është një Republike demokratike, e themeluar mbi punën.

Sovraniteti i përket popullit, që e ushtron atë në format dhe brenda kufijve të Kushtetutës.

Neni 2 - Republika njeh dhe garanton të drejtat e padhunueshme të njeriut, qoftë si individ, qoftë në formacionet shoqërore ku zhvillohet personaliteti i tij, dhe kërkon përmbushjen e detyrave të domosdoshme të solidaritetit politik, ekonomik e shoqëror.

Neni 3 - Të gjithë shtetasit kanë dinjitet shoqëror të njëjtë dhe janë të barabartë përpara ligjit, pa dallim seksi, race, gjuhe, feje, mendimi politik, kushtesh vetjake e shoqërore.

Është detyrë e Republikës heqja e pengesave të karakterit ekonomik e shoqëror, që kufizojë në praktikë lirinë dhe barazinë e shtetasve, ndalojnë zhvillimin e plotë të personalitetit njerëzor dhe pjesëmarrjen efektive të së gjithë punonjësve në organizimin politik, ekonomik e shoqëror të Vendit.

Neni 4 - Republika u njeh të gjithë shtetasve të drejtën për punë dhe nxit kushtet që e bëjnë efektive këtë të drejtë. Çdo shtetas ka të drejtë të kryejë, sipas mundësive dhe zgjedhjes së vet, një aktivitet ose një profesion që ngre të ardhmen materiale ose shpirtërore të shoqërisë.

Neni 5 - Republika, një dhe e pandarë, njeh dhe zhvillon autonomitë lokale; kryen, në shërbimet që varen nga Shteti, decentralizimin administrativ më të gjerë; i përshtat parimet dhe metodat e legjisllacionit të saj me kërkesat e autonomisë dhe të decentralizimit.

Neni 6 - Republika mbron me norma të posaçme pakicat gjuhësore.

Neni 7 - Shteti dhe Kisha katolike, janë, secili në rendin e vet, të pavarur dhe sovranë.

Marrëdhëniet e tyre rregullohen nga Paktet e *Laterano*-s. Ndryshimet e Pakteve, të pranuar nga të dyja palët, nuk kërkojnë rishikimin e Kushtetutës.

Neni 8 - Të gjitha besimet fetare janë njësoj të barabarta përpara ligjit.

Besimet fetare, të ndryshme nga ai katolik, kanë të drejtë të organizohen sipas statuteve të tyre, për aq sa këto nuk vijnë në kundërshtim me rendin juridik italian.

Marrëdhëniet e tyre me shtetin rregullohen me ligj mbi bazën e marrëveshjeve me përfaqësitë përkatëse.

Neni 9 - Republika nxit zhvillimin e kulturës dhe kërkimin shkencor e teknik. Kujdeset për mjedisin dhe pasuritë historike e artistike të Kombit.

Neni 10 - Rendi juridik italian u përshtatet normave të së drejtës ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar.

Gjendja juridike e shtetasit të huaj rregullohet me ligj, në pajtim me normat dhe traktatet ndërkombëtare.

Të huajit, të cilit në vendin e vet i ndalohej ushtrimi i lirive demokratike të garantuara nga Kushtetuta italiane, ka të drejtë strehimi në territorin e Republikës, sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Nuk lejohet ekstradimi i shtetasit të huaj për vepra penale politike.

Neni 11 - Italia urren luftën si instrument cënues të lirisë së popujve të tjerë dhe si mjet zgjidhjeje të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, lejon, në kushte barazie me shtetet e tjera, kufizime të sovranitetit për aq sa janë të nevojshme për një rend që të sigurojë paqen dhe drejtësinë ndërmjet Kombeve; ajo inkurajon dhe favorizon organizatat ndërkombëtare që kanë këtë qëllim.

Neni 12 - Flamuri i Republikës është trengjyreshi italian: i gjelbër, i bardhë dhe i kuq, me tre shirita vertikale me përmasa të barabarta.

PJESA E PARË

Te drejtat dhe detyrat e shtetasve

KREU I - Marrëdhëniet civile

Neni 13 - Liria personale është e padhunueshme. Nuk pranohet asnjë formë mbajtjeje, këqyrjeje ose kontrolli vetjak, dhe as ndonjë kufizim tjetër i çfarëdoshëm i lirisë personale, përveçse me një vendim të arsyetuar të organit gjyqësor dhe vetëm në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga ligji. Në raste të jashtëzakonshme domosdoshmërie dhe urgjence, të treguara shprehimisht në ligj, autoriteti i sigurisë publike mund të marrë masa të përkohshme, të cilat brenda 48 orëve duhet t'i komunikohen organit gjyqësor dhe, në rast se ky nuk i vleftëson brenda dyzetë e tetë orëve pasardhëse, quhen të hequra dhe mbeten pa asnjë efekt.

Dënohet çdo dhunë fizike ose morale ndaj atyre personave që sidoqoftë u nënshtrohen kufizimeve të lirisë. Me ligj caktohen kufijtë maksimalë të paraburgimit.

Neni 14 - Banesa është e padhunueshme. Në të nuk mund të kryhen kontrole ose këqyrje a sekuestrime, përveçse në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj, sipas garancive të parashikuara për lirinë personale. Kontrollat dhe këqyrjet për arsye shëndetësore dhe të sigurisë publike ose për qëllime ekonomike e fiskale rregullohen me ligje të veçanta.

Neni 15 - Liria dhe fshehtësia e korrespondencës dhe e çdo formë tjetër komunikimi janë të padhunueshme. Kufizimi i tyre mund të vijë vetëm pas një akti të organit gjyqësor me garancitë e përcaktuara me ligj.

Neni 16 - Çdo shtetas mund të lëvizë e të qëndrojë lirisht në çdo pjesë të territorit kombëtar, me përjashtim të kufizimeve që ligji cakton në vijë të përgjithshme për shkaqe shëndetësore ose sigurie. Asnjë kufizim nuk mund të vihet duke u nisur nga motive politike. Çdo shtetas është i lirë të dalë nga territori i Republikës dhe të kthehet sërish, përveç detyrimeve ligjore.

Neni 17 - Shtetasit kanë të drejtë të mblidhen paqësisht dhe pa armë. Për tubimet, edhe në vend të hapur për publikun, nuk kërkohet njoftim paraprak. Për tubimet në vende publike i duhet dhënë njoftim paraprakisht autoriteteve, të cilat mund t'i ndalojnë vetëm për motive sigurie ose të një rreziku publik.

Neni 18 - Shtetasit kanë të drejtë të organizohen lirisht, pa autorizim, për qëllime që nuk u ndalohen individëve nga ligji penal. Ndalohen shoqatat e fshehta dhe ato që ndjekin, qoftë edhe tërthorazi, qëllime politike nëpërmjet organizimeve me karakter ushtarak.

Neni 19 - Të gjithë kanë të drejtë të shpërhapin lirisht besimin e tyre fetar në çfarëdo lloj forme, individuale ose kolektive, ta propagandojnë atë dhe të ushtrojnë kultin privatisht a publikisht, vetëm mos qofshin rite në kundërshtim me zakonet e mirë.

Neni 20 - Karakteri kishtar dhe qëllimi i fesë ose i kultit të një shoqate a institucioni nuk mund të jenë shkak i kufizimeve të veçanta legjislativë, dhe as i barrëve të veçanta fiskale për krijimin e tyre, në statusin juridik si dhe çdo formë të veprimtarisë së tyre.

Neni 21 - Të gjithë kanë të drejtë të shprehin lirisht mendimin e tyre me fjalë, shkrim dhe me çdo mjet tjetër shpërhapjeje. Shtypi nuk mund t'u nënshtrohet autorizimeve ose censurave.

Mund të vazhdohet me sekuestrim vetëm me akt të arsyetuar të organit gjyqësor në rast krimesh, për të cilat ligji për shtypin e autorizon atë shprehimisht, ose në rast shkeljesh të normave që vetë ligji parashikon për përcaktimin e përgjegjësve.

Në të këtyra raste, kur ka urgjence absolute dhe nuk është e mundur ndërhyrja në kohë e organit gjyqësor, sekuestrimi i shtypit periodik mund të kryhet nga oficerë të policisë gjyqësore, të cilët menjëherë, dhe kurrë përtej 24 orëve, duhet të njoftojnë organin gjyqësor. Nëse ky i fundit nuk e vleftëson në 24 orët pasardhëse, sekuestrimi konsiderohet i hequr dhe pa asnjë lloj efekti. Ligji mund të caktojë, me norma të karakterit të përgjithshëm, bërjen publike së mjeteve të financimit të shtypit periodik. Ndalohen botimet me shtyp, shfaqjet dhe të gjitha manifestimet e tjera në kundërshtim me zakonet e mirë. Ligji cakton masat e përshtatshme për parandalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve.

Neni 22 - Askush nuk mund të privohet, për shkaqe politike nga zotësia juridike, shtetësia dhe nga emri.

Neni 23 - Asnjë detyrim personal ose pasuror nuk mund të vihet, përveçse në bazë të ligjit.

Neni 24 - Të gjithë mund të veprojnë në gjykim për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme. Mbrojtja është e drejtë e padhunueshme në çdo gjendje e fazë të procedimit. U sigurohen personave që nuk janë në gjendje, me institute të posaçme, mjetet për të vepruar dhe për t'u mbrojtur përpara çdo juridiksioni. Ligji përcakton kushtet dhe mënyrat për ndreqjen e gabimeve gjyqësore.

Neni 25 - Askush nuk mund të hiqet nga gjyqtari i natyrshëm i paracaktuar me ligj. Askush nuk mund të dënohet, përveçse në bazë të një ligji, që të ketë hyrë në fuqi përpara kryerjes së veprës. Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurisë, përveçse në rastet e parashikuara në ligj.

Neni 26 - Ekstradimi i shtetasit mund të lejohet vetëm nëse është i parashikuar shprehimisht në konventat ndërkombëtare .

Dhe nuk mund të lejohet në asnjë rast për vepra penale politike.

Neni 27 - Përgjegjësia penale është vetjake. I pandehuri nuk konsiderohet fajtor deri në dënimin përfundimtar. Dënimet nuk mund të jenë trajtime në kundërshtim me ndjenjat njerëzore dhe duhet të synojnë në riedukimin e të dënuarit. Nuk lejohet dënimi me vdekje, përveç rasteve të parashikuara nga ligjet ushtarake të kohës së luftës.

Neni 28 - Funkionarët dhe nëpunësit e Shtetit dhe të institucioneve publike janë përgjegjës drejtpërsëdrejti, sipas ligjeve penale, civile dhe administrative, për veprimet e kryera duke shkelur të drejtat. Në raste të tilla përgjegjësia civile shtrihet te Shteti dhe tek institucionet publike.

KREU II - MARRËDHËNIET ETIKO- SHOQËRORE

Neni 29 - Republika njeh të drejtat e familjes si shoqëri natyrore të bazuar mbi martesën. Martesa rregullohet mbi bazën e barazisë morale e juridike të bashkëshorteve, brenda kufijve të caktuar me ligj për garantimin e unitetit familjar.

Neni 30 - Është detyrë dhe e drejtë e prindërve mbajtja, arsimimi dhe edukimi i fëmijëve, edhe kur kanë lindur jashtë martesës. Në rastet e paftësisë së prindërve, ligji përcakton mënyrën e shlyerjes së detyrimeve të tyre. Ligji u siguron fëmijëve të lindur jashtë martesës çdo mbrojtje juridike e shoqërore, në pajtim me të drejtat e anëtarëve të familjes së ligjshme. Ligji përcakton normat dhe caqet për kërkimin e atësisë.

Neni 31 - Republika lehtëson me masa ekonomike dhe përkujdesje të tjera, krijimin e familjes dhe përmbushjen e detyrave përkatëse, me një vëmendje të veçantë për familjet e mëdha.

Mbron nënën, fëmijët dhe rininë, duke favorizuar institutet e nevojshme për këtë qëllim.

Neni 32 - Republika kujdeset për shëndetin si një e drejtë themelore e individit dhe një interes i kolektivitetit, dhe garanton mjekime falas te skamurit. Askush nuk mund të detyrohet për një trajtim shëndetësor të përcaktuar veçse me dispozite ligjore. Ligji në asnjë rast nuk mund të shkele kufijtë që imponon respekti për njeriun.

Neni 33 - Arti dhe shkenca janë të lirë dhe i lirë është mësimi i tyre. Republika cakton normat e përgjithshme për arsimin dhe krijon shkolla shtetërore për të gjitha sistemet dhe shkallët.

Institucione dhe subjekte private kanë të drejtë të krijojnë shkolla dhe institute edukimi, pa shpenzime për Shtetin.

Ligji, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të shkollave jo shtetërore që kërkojnë të njehsohen, duhet t'u sigurojë atyre siguri të plotë dhe nxënësve të tyre një trajtim shkollor të barazvlefshëm me atë të nxënësve të shkollave shtetërore.

Është i detyrueshëm një provim shtetëror për pranimin në shkollat e çfarëdo rendi dhe shkalle ose për përfundimin e tyre dhe për aftësimin në ushtrimin e profesionit.

Institucionet e kulturës së lartë, universitetet dhe akademitë, kanë të drejtë të vendosin vende autonome brenda kufijve të përcaktuara nga ligjet e Shtetit.

Neni 34 - Shkolla është e hapur për të gjithë. Arsimi i ulët, i dhënë të paktën për tetë vjet, është i detyrueshëm dhe falas. Ata që janë të aftë dhe që e meritojnë, edhe pse pa mundësi, kanë të drejtë të arrijnë shkallët më të larta të studimeve.